

**BLERINA KUQI****SHKOLLAT KATOLIKE GJATË PUSHTIMIT ITALIAN  
(PRILL 1939-SHTATOR 1943)****Abstrakt:**

*Shkollat katolike, kolegji “Saverian” i drejtuar nga etërit jezuitë, liceu “Illyricum” i drejtuar nga françeskanët dhe Seminari Papnor, që përgatiste priftërinj vendas dhe varej nga Selia e Shenjtë, të krijuara që në gjysmën e dytë të shek. XIX e vazhduan veprimtarinë e tyre arsimore edhe gjatë pushtimit italian. Përmes burimeve arkivore, pjesë e fondeve të Arkivit Qendror Shtetëror dhe literaturës historike, synojmë të pasqyrojmë një panoramë sa më të plotë të ecurisë së shkollave katolike fetare, duke u ndalur në shtrirjen, organizimin, programet e lëndët mësimore që zhvilluan, vështirësitë financiare me të cilat u ndeshën, si dhe në përpjekjet e pushtuesve italianë për të penguar, sidomos, funksionimin normal të shkollave të Urdhrit Françeskan, të përbërë vetëm nga klerikë vendas. Në lidhje me këtë tematikë, artikulli përbën risi për studimet rreth Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Ai synon t'i japë përgjigje pyetjeve: Cilat qenë problematikat e krijuara në shkollat katolike pas prillit të vitit 1939? Cili ishte qëllimi i reformave në fushën arsimore? A preknin ato institucionet shkollore fetare? Pse ndaj Urdhrit Françeskan dhe shkollave të tyre u mbajt një qëndrim më kundërshtues nga ana e pushtuesve italianë?*

**Fjalë kyçe:**

Pushtimi italian, shkolla katolike, Urdhri Jezuit, Urdhri Françeskan, statusi ligjor, motrat françeskane Stigmatine

**Historik i shkurtër i shkollave katolike deri në prill 1939**

Komunitetet fetare, midis tyre dhe ai katolik, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e traditës arsimore në Shqipëri. Ato janë përpjekur për hapjen e shkollave dhe arsimimin e nxënësve në gjuhën

amtare, duke u ballafaquar me pengesat e administratës osmane, si edhe me nacionalizmat ekstremë të fqinjëve, të cilët e kanë penguar dhe ngadalësuar këtë proces. Mësimet e para në shkrim e lexim, u morën fillimisht në xhami e kisha dhe gradualisht u krijuan institucionet arsimore, ku u përgatitën jo vetëm klerikët fetarë, por mësuan edhe shumë të rinj, një pjesë e të cilëve u bënë figura me peshë të rëndësishme në skenën politike dhe fushën letrare.

Nën pushtimin osman katolikët shqiptarë e ruajtën besimin e tyre dhe lidhjet me Vatikanin i mbajtën përmes Propagandës Fide, me qendër në Romë. Austrisë iu njoh e drejta, e trashëguar më parë nga Venediku, për mbrojtjen e të gjithë katolikëve të Evropës nën sundimin osman<sup>1</sup>, si dhe për të mbështetur klerin e për të hapur shkolla.<sup>2</sup> Pas vitit 1918 dhe me shpërbërjen e Perandorisë Austro-Hungareze merr fund protektorati kulturor mbi katolikët shqiptarë.

Në Shqipëri vepronin dy urdhra kryesorë katolikë: françeskanët dhe jezuitët. Vendosja e tyre u mundësua nga Konkordati që ishte lidhur mes Vatikanit dhe Austrisë, në vitin 1855. Në Shkodër me financimin e tyre, më 1857 u ndërtua seminari i jezuitëve, i cili në vitin 1862 u ngrit në rangun e një Seminari Papnor [ndërdioqezan].<sup>3</sup> Më 1861 u themelua seminari françeskan.<sup>4</sup> Ata hapën një shtypshkronjë, ku u shtypën libra fetarë e laikë në gjuhën shqipe, si dhe nxorën organin periodik letrar-kulturor “Hylli i Dritës”, Shkodër, (1913-1944). Jezuitët, hapën shtypshkronjën “Zoja e Papërlyeme”, kishin organin e tyre periodik “Elçija e zemrës së Jezu Krishtit”, Shkodër, si dhe themeluan kolegjin “Saverian”, i cili e vuri theksin tek arsimimi në gjuhën shqipe, krahas asaj italiane. Nga kjo shkollë dolën figura kombëtare dhe shkrimtarë të njohur si Faik Konica, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Ernest Koliqi etj.<sup>5</sup> Në vitin 1921 në Shkodër, u hap Gjimnazi Françeskan me drejtor at Gjergj Fishtë. Duke qenë gjimnaz klasik, ashtu si shkollat e Austrisë,

<sup>1</sup> Bardhyl Ukcama, *Shqiptarët në qytetërimin perëndimor*, Tiranë: Princi, 2009, f. 102.

<sup>2</sup> Hasan Bello, *Shqipëria, Kisha Katolike dhe Vatikani (nga fundi i shek. XIX-1939)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2019, f. 18.

<sup>3</sup> Markus W. E. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën. “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (1870-1945)*, Tiranë: Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, 2016, f. 51-52.

<sup>4</sup> B. Ukcama, *Shqiptarët në qytetërimin perëndimor ...*, f. 103-104.

<sup>5</sup> *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë: Nënë Tereza, 2003, f. 395.

deri në vitin 1928 kishte sistemin me 7 klasë e pas këtij viti me pranimin e programit të Ministrisë së Arsimit, u bë me 8 klasë.<sup>6</sup> Në shtator 1939 gjimnazi merr emrin “Lyceum Illyricum”.<sup>7</sup>

Sistemi arsimor në Shqipëri, pas Shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1939, iu nënshtrua ndryshimeve të vazhdueshme. Me gjithë vështirësitë dhe mungesat e shumta, ai u fut në rrugën e konsolidimit dhe të laicizimit. Nga reformat e ndërmarra gjatë viteve të mbretërimit të Ahmet Zogut, më e diskutueshja ishte shtetëzimi i shkollës shqiptare. Qëllimi ishte që “t’i jepej një prirje më homogjene shkollës kombëtare”.<sup>8</sup> Ajo u shtri në të gjitha aspektet e sistemit shkollor, por “pa u përgojuar feja në shkollë” duke respektuar ndjenjat fetare të popullsisë si një e drejtë civile e pamohueshme.<sup>9</sup> Në fakt, kjo reformë ishte një masë antiitaliane dhe një riafirmim i pavarësisë së Shqipërisë përballë ndërhyrjes së shtetit italian.<sup>10</sup>

Zbatimi i Reformës Ivanaj, prill 1933, çoi në mbylljen e të gjitha shkollave private.<sup>11</sup> Gjithsej 85 shkolla nga të cilat: 21 shkolla shqiptare private jo fetare; 14 shkolla klerikale myslimane; 4 shkolla klerikale ortodokse e 10 shkolla private të minoritetit grek, si edhe 19 shkolla të huaja për shqiptarë.<sup>12</sup> Të njëjtin fat patën edhe 17 shkolla katolike që i përkisnin jezuitëve, françeskanëve dhe motrave françekane stigmatine, në të cilat mësonin 2560 nxënës. 12 prej këtyre shkollave ndodheshin në Shkodër, ndërsa pjesa tjetër në Tiranë. U mbyllën 8 shkolla të vogla fillore me 160 nxënës, në zona ku nuk kishte as shkolla shtetërore. Për përgatitjen e klerit u lejuan vetëm shkollat fetare të varura prej komuniteteve, me kusht që të mos zhvillonin propagandë antishqiptare.<sup>13</sup>

Përpjekjet e komunitetit katolik për mbrojtjen e shkollave të tyre u

<sup>6</sup> Ludovik Shllaku, *Shkollat klerikale*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2002, f. 104-105.

<sup>7</sup> Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri 1919-1996*, Tiranë: Qendra Botuese Shoqata Jezuite, 2010, f.102.

<sup>8</sup> Zoi Xoxa, *10 vjet mbretëri*, Tiranë, 1938, f.156.

<sup>9</sup> *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III (1925-1939), Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 277-278.

<sup>10</sup> Roberto Morozzo della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë: Elena Gjika, 1994, f.144.

<sup>11</sup> Iljaz Gogaj, *Mirash Ivanaj - personalitet i shquar i universit shqiptar*, Tiranë: Erik, 2004, f. 100-110; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. III, f.276.

<sup>12</sup> *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik...*, vëll. I, f. 444.

<sup>13</sup> Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 225-226.

intensifikuan, si në planin e brendshëm, ashtu edhe të jashtëm. Në vitet 1933-1935, ipeshkvinjtë katolikë shqiptarë iu drejtuan Lidhjes së Kombeve, duke kërkuar ndërhyrjen e saj pranë qeverisë shqiptare për heqjen e masave kundër shkollave të tyre.<sup>14</sup> Pas dy vjetësh, çështja e shkollave private u kthye në një problem me karakter ndërkombëtar. Qeveria greke iu drejtua Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, e cila nuk vërejti shkelje të të drejtave të minoriteteve, por meqë çështja kishte karakter juridik ia drejtoi Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës, i cili me shumicë votash u shpreh kundër shtetëzimit të shkollave private.<sup>15</sup> Qeveria shqiptare në zbatim të vendimit riçeli shkollat katolike, si dhe ato private të minoriteteve greke.<sup>16</sup>

Në prag të pushtimit italian, në Shqipëri kishte 22 kopshte për fëmijë, 40 edukatore, 647 shkolla fillore të sistemit me pesë klasë, në të cilat punonin 1340 mësues e mësonin 56932 nxënës. Arsimi i mesëm ishte i ndarë në dy cikle: i ulët dhe i lartë, me dy degë klasike dhe reale. Më të vjetrat ishin gjimnazi “Illyricum” i klerit françeskan dhe kolegji “Saverian” i etërve jezuitë. Krahas tyre vepronin edhe gjimnazi i shtetit po në Shkodër, liceu frëng në Korçë, liceu në Gjirokastër, gjimnazi i Tiranës, shkolla normale, Instituti Femëror “Nëna Mbretëreshë”. Shkolla profesionale ishin ajo teknike në Tiranë, tregtare në Vlorë dhe shkolla bujqësore në Kavajë. Po ashtu kishte edhe shkolla profesionale teknike, të ulëta pune etj.<sup>17</sup>

### **Pushtimi i Shqipërisë dhe problematika e krijuar në kolegjin “Saverian” dhe liceun “Illyricum”**

Në prill të vitit 1939, pas organizimit të administratës shtetërore nga pushtuesit italianë, në krye të Ministrisë së Arsimit u emërua shkrimtari e studiuesi i njohur Ernest Koliqi, i cili qëndroi në këtë post deri në dhjetor 1941. Gjatë ushtrimit të detyrës ai u përball përveç të tjerave edhe me rezistencën gjithnjë në rritje të nxënësve e mësuesve, të cilët

<sup>14</sup> R. M. della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri...*, f. 157.

<sup>15</sup> Beqir Meta, “Marrëdhëniet shqiptaro-greke pas vendimit të Gjykatës së Hagës për çështjen e shkollave minoritare (prill-gusht 1935)”, në *Studime historike*, nr. 3-4, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2011, f. 69.

<sup>16</sup> *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar ...*, vëll. I, f. 455.

<sup>17</sup> Fatmira Rama, *Dukuri arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*, Tiranë: Argeta-LMG, 2005, f. 25-26.

kundërshtonin fashistizimin e shkollës shqiptare, që nga refuzimi i zhvillimit të lëndëve që shërbenin për indoktrinimin ideologjik fashist të rinjve, deri tek kundërshtimi i modeleve të reja të sjelljes e simboleve si: përhëndetja fashiste, mbajtja e detyruar e uniformës, frekuentimi i veprimtarive të ndryshme me karakter fashist apo ekspozimit të simboleve fashiste me rastin e festave. Vatër e rezistencës antiitaliane dhe antifashiste u bë edhe gjimnazi francez në Shkodër. Sipas drejtorit të tij, që nga viti 1938, at Donat Kurti, flamuri kombëtar nuk u zëvendësua me atë italian “veç kur ia çoi vetë Ministria”. Gjithashtu shumë urdhra që vinin prej saj mbeteshin në arkiv e nuk zbatoheshin, si dhe nuk lejuan që në hyrje të gjimnazit të shkruheshin parulla apo të vendoseshin portrete sundimtarësh.<sup>18</sup>

Si një masë parandaluese për këto kundërshtime të hapura ndaj pushtuesve, autoritetet shtetërore vendosën mbylljen e shkollave të mesme deri në fund të majit të vitit 1939 me justifikimin se do të bëheshin verifikime për “një spastrim rrënjësor”, si dhe do të “shqyrtoheshin dhe përmirësoheshin” programet shkollorë.<sup>19</sup> Natyrisht kjo nuk kishte të bënte vetëm me programet mësimore, por edhe me hartimin e listave të mësuesve, që ata i konsideronin si kundërshtarë. Gjithashtu filluan të merreshin masa të mëtejshme edhe për italianizimin e fashistizimin e shkollave shqiptare, për përgatitjen e rinisë me qëllime filoitaliane e shije fashiste dhe në një fazë të mëvonshme do të punohej për “oksidantizimin, italianizimin dhe shballkanizimin e popullit shqiptar”.<sup>20</sup> Qëllimi kryesor ishte krijimi i “njeriut të ri” sipas ideologjisë fashiste.<sup>21</sup>

Me gjithë këtë atmosferë jo shumë të favorshme, shpresat e katolikëve përsa i përket arsimit të tyre privat, në krahasim me myslimanët dhe ortodoksët, ishin më të mëdha, pasi me italianët i lidhte edhe besimi i përbashkët. Tashmë me ndryshimin e situatës politike, katolikët mendonin se ekzistonin mundësitë që të merreshin në

<sup>18</sup> Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2003, f. 255.

<sup>19</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), Grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2009, f. 36.

<sup>20</sup> *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik...*, vëll. I, f. 457.

<sup>21</sup> Andrea Di Nicola, *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare 1939-1943*, Tiranë: Botart, 2013, f. 14.

konsideratë disa nga sugjerimet e tyre, për një reformim të sistemit shkollor ekzistues, të cilat i paraqitën në një promemorie të titulluar “Projektligj mbi reformën shkollore në Mbretërinë e Shqipërisë”. Dokumenti që disponojmë i drejtohet Mëkëmbësisë, është pa datë, por i përket vitit 1939. Është pa autor pasi nuk është firmosur prej askujt, por jemi të mendimit se është shkruar nga at Gjergj Fishta, duke u nisur nga përmbajtja, si dhe nga fakti që një tekst i njëjtë ndodhet edhe në fondin e tij personal.<sup>22</sup>

Në këtë promemorje përmes analizës, autori përpiqet të japë argumente mbi nevojën e organizimit të sistemit arsimor në Shqipëri në bazë të besimeve fetare, duke kundërshtuar reformën arsimore të vitit 1933 dhe laicizimin e shkollës shqiptare. Sipas tij, ligji shkollor i një shteti duhej të pasqyronte progresin moral, material e shpirtëror të një populli. Duke marrë në konsideratë mentalitetin e popullit shqiptar, ai krahasonte parimet morale e sociale, si dhe dogmat fetare të krishterimit e islamit. Në promemorie mbahej qëndrim kritik ndaj laicizimit të shkollës. Sipas saj, nxënësit që i përkisnin besimeve të ndryshme fetare, nuk mund të qëndronin në të njëjtën shkollë. Për këtë arsye duhej të kundërshtohej çdo ligj, që do të miratonte shkollat mikse, në të cilat do të mësonin si myslimanët, ashtu edhe të krishterët, duke treguar vështirësitë dhe mospërputhjen e mentaliteteve midis tyre. Këto shkolla laike konsideroheshin edhe antifetare.<sup>23</sup>

Në Promemorie gjithashtu propozohej që të futej në procesin mësimor, zhvillimi i mësimit të besimit në shkollat e mesme shtetërore, ndërsa në ato fillore ky mësim ishte bërë pjesë e programit që gjatë viteve të monarkisë. Tekstet dhe programi për këtë lëndë, të hartoheshin nga komunitetet fetare në bashkëpunim me autoritetet kompetente shtetërore. Ky mësim mund të zhvillohej në ambiente të veçanta, për nxënësit e të dyja gjinive. Po ashtu, Mëkëmbësia në përputhje me normat ligjore, duhej të lejonte institucionet fetare shqiptare e italiane, të cilitdo besimi, të hapnin shkolla private fillore e të mesme, gjimnaze etj., të cilat do të mbaheshin e kontrolltoheshin nga shteti dhe duhej të ishin të

<sup>22</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 161, Viti (më tej: V.) 1939, Dosja (më tej: D.) 659, fl. 1. Progetto di legge sulla riforma scolastica nel regno d’Albania (Projektligj mbi reformën shkollore në Mbretërinë e Shqipërisë), (pa autor, vend dhe datë), 1939.

<sup>23</sup> *Po aty*, fl. 7-8.

barazvlefshme me shkollat shtetërore.<sup>24</sup>

“Projektligj mbi reformën shkollore në Mbretërinë e Shqipërisë” i propozuar nga françeskanët, më shumë ishte një përpjekje nga ana e tyre për të kundërshtuar shkollën laike shtetërore, duke shfrytëzuar situatën e re politike që ishte krijuar, me shpresën se mbase italianët për shkak të besimit të përbashkët do t’i mbështetnin. Por, për ta në kuadër të instalimit të pushtetit dhe duke u nisur nga interesa politike, më e rëndësishme ishte mbështetja që françeskanët duhej t’i jepnin regjimit të ri, sesa plotësimi i kërkesave që do të sillnin ndryshime radikale në sistemin arsimor. Tradita e krijuar, që nga viti 1933 dhe normaliteti në shkollat shtetërore, ku nxënësit pa dallim besimi mësonin dhe edukoheshin normalisht flisnin për sukses të shkollave laike mikse.

Françeskanët ishin një urdhër i përbërë vetëm nga elementë vendas shqiptarë dhe që në muajt e parë të pushtimit u vunë nën shënjestrën e italianëve. Ata ishin të njohur për qëndrimet e tyre kombëtare e kundërshtuese ndaj pushtuesve. Përplasja e tyre me Mëkëmbësinë, sidomos me Salvatore Meloni-n (Salvatore Meloni), Sekretar i Përgjithshëm pranë Mëkëmbësisë dhe ish konsulli i Italisë në Shkodër, i cili kishte si detyrë të mbikëqyrte personalisht interesat italiane u bë për shkak të rezistencës antiitaliane të françeskanëve. Ai mbajti qëndrim armiqësor ndaj tyre madje përpiloi një listë me emra, që u njoh si “lista Meloni” dhe këmbënguli që të largoheshin nga Shqipëria ose të paktën nga Shkodra, disa fretën mes tyre at Anton Harapi, at Frano Kiri, at Antonin Fishta, at Atanasio Gegaj, at Gjon Shllaku, at Aleksandër Luli, [Lekë Luli] të gjithë profesorë të liceut françeskan në Shkodër, pasi ishin kundër regjimit italian. Të gjitha këto ndodhën gjatë kohës që Provinciali Ciprian Nika, nuk ishte në Shqipëri. Edhe pas kthimit të tij situata do të vijë duke u përkeqësuar më shumë, deri në kërkesën për shkarkimin e Provincialit<sup>25</sup>, i cili shikohej si “njeri i padishruem prej Qeverisë” [Italisë].<sup>26</sup> Edhe në vitet e mëvonshme, kur lufta ndaj pushtuesve do të intensifikohej dhe brenda vendit do të formoheshin grupet e ndryshme politike, françeskanët do të konsideroheshin si ajo pjesë e nacionalistëve shqiptarë “të cilët janë treguar antifashistë dhe janë të ndeshur me

<sup>24</sup> *Po aty*, fl. 9-10.

<sup>25</sup> *Po aty*, F. 133, V. 1939, D. 1162, fl.7. Promemorije e Provincialit Ciprian Nika rreth marrëdhënieve mes autoriteteve italiane dhe Provincës Françeskane në Shqipëri, Romë, 23 nëntor 1939.

<sup>26</sup> D. Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare ...*, f. 258.

jezuitët”<sup>27</sup>, duke ruajtur qëndrimin e tyre kombëtar.

Ndërkohë që situata mbetej e tensionuar, pa mbaruar ende viti shkollor 1938-1939, si dhe për të dhënë një mesazh paqtimi, ministri i Arsimit Ernest Koliqi i shoqëruar dhe nga Sistilio Montanelli (Sistilio Montanelli) bënë një vizitë zyrtare në gjimnaz. Gjatë takimit me nxënës e profesorë, ministri lavdëroi punën dhe veprimtarinë e françeskanëve në fushën arsimore.<sup>28</sup>

Në mbarim të po këtij viti shkollor, sipas një pasqyre të hartuar nga Provinciali i françeskanëve, at Ciprian Nika, rezultonte se numri i nxënësve të regjistruar në shkollat fillore, të drejtuara prej tyre, kishte qenë 196 dhe në gjimnaz 260 nxënës.<sup>29</sup> Po këtë vit doli matura e parë, pas rihapjes së shkollave private në vitin 1936 dhe rifillimit nga puna të gjimnazit. Për provimet e maturës, ngrihej një komision i posaçëm i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, drejtori i shkollës dhe mësuesit e lëndës. Në Shkodër, për të marrë pjesë në komision si përfaqësues i Ministrisë u dërgua Eqrem Çabej dhe Aleko Tashko. U diplomuan 16 maturantë, 13 civilë e 3 françeskanë.<sup>30</sup>

Me fillimin e vitit të ri shkollor, në shtator 1939, marrëdhëniet me italianët ishin ende të acaruar, pasi kërkesa për shkarkimin e Provincialit nuk ishte zbatuar. Pasojë e këtij qëndrimi kundërshtues do të ishte goditja ndaj shkollave të françeskanëve, deri në atë pikë sa të vihej përsëri në pikëpyetje funksionimi normal i gjimnazit, i cili ndryshoi emërtimin dhe filloi të thirrej liceu “Illyricum”. Problemi kryesor qëndronte tek vendet vakante të tre profesorëve, si dhe ndihmat financiare nga ana e qeverisë për mbajtjen e shkollës. Drejtori, at Donat Kurti, në lidhje me këtë çështje i shkroi ministrit të Arsimit, Koliqi, por përgjigjja që mori, ishte se kjo çështje mund të zgjidhej vetëm prej Mëkëmbësisë. Në tetor 1939, ai i drejtohet Mëkëmbësit Francesco Jacomoni (Françesko Jakomoni), duke i parashtruar disa kërkesa, të cilat të ndara sipas tipit të shkollës ishin: për shkollat mashkullore duheshin tre profesorë për liceun, pesë mësues për shkollat fillore, si dhe një ndihmë financiare prej 20.000 fr.sh.; për shkollat e motrave Stigmatine [motra françeskane] nevojiteshin

<sup>27</sup> AQSH, F. 14 AP, Lista Nr.1, Njësi ruajtje Nr.5, V. 1942, fl. 6. Kopje e letrës së Koço Tashkos drejtuar Internacionales III Komuniste, pa datë.

<sup>28</sup> D. Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare ...*, f. 256.

<sup>29</sup> AQSH, F. 132, V. 1939, D. 18, fl. 7. Pasqyrë e Provincialit të françeskanëve at Ciprian Nika, Shkodër, 30 gusht 1939.

<sup>30</sup> D. Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare ...*, f. 257.



tre mësues për shkollat fillore, të cilëve duhej t'u paguhej rroga mujore, si dhe një ndihmë financiare për kopshtet, që i administronin vetë ato. Ai jo vetëm u përcoll nga nëpunës të lartë, mes tyre Meloni, pa asnjë zgjidhje, por iu dha ultimatum i që në qoftë se dëshironin të plotësoheshin kërkesat e tyre, Provinciali duhej të jepte dorëheqjen.<sup>31</sup>

Liceu "Illyricum" ishte në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe kërkesat e parashtruara nga drejtori, at Donat Kurti, duhej të merrnin përgjigje prej saj. Delegimi i zgjidhjes së këtij problemi tek Mëkëmbësi, tregonte pafuqinë e administratës shqiptare nën pushtim për të marrë vendime autonome dhe konfirmonte kontrollin e plotë që ushtronin italianët mbi të. Gjithashtu u bë e qartë se veprimet ndaj françeskanëve kishin karakter politik, duke u përpjekur t'i vinin ata nën kontroll. Të shtrenguar për të marrë një vendim dhe të vendosur për të mos plotësuar kërkesën italiane, pasi shqyrtuan mirë pasojat që do të kishin, trupi mësimor i liceut vendosi që të mbyllej shkolla. Nga ana tjetër, françeskanët nuk ndenjnë duarkryq. At Gjergj Fishta, që në këtë kohë ndodhej në Vatikan, ndërhyri pranë Atit të Shenjtë dhe solli lajmin se shkollat do të rihapeshin. Delegati Apostolik Leone Giovanni Battista Nigris (Leone Xhovani Batista Nigris) shkoi vetë për t'ia komunikuar Provincialit vendimin e Vatikanit, madje argjipeshkvi i Shkodrës Gaspër Thaçi, u tregua i gatshëm për të dhënë 500 napolona hua, në rast se nuk do të akordohej ndihmë financiare nga ana e shtetit.<sup>32</sup> At Frano Kiri u paraqit pranë këshilltarit Mario Morandi (Mario Morandi), në nëntor 1939 dhe deklaroi se kishte marrë urdhër nga Vatikani për të rihapur shkollat e tyre, me çdo kusht, duke e vënë Ministrinë e Arsimit para një fakti të kryer. Kjo e fundit bëri një hap prapa e detyruar nga presioni i Selisë së Shenjtë, duke u shprehur se nuk kishte "asnjë kundërshtim", me kusht që të dërgoheshin pranë saj listat me emrat dhe titujt e mësuesve, të mos regjistroheshin më shumë se 150 nxënës, për shkak të numrit të mbyllur të regjistrimeve, si dhe të mos bëhej asnjë propagandë nga ana e françeskanëve për të tërhequr nxënës nga shkollat shtetërore në gjimnazin e tyre.<sup>33</sup>

<sup>31</sup> *AQSH*, F. 161, V. 1939, D. 253, fl. 1. Letër e drejtorit të Liceut "Illyricum" at Donat Kurti drejtuar Mëkëmbësit Jacomoni, Shkodër, 25 tetor 1939

<sup>32</sup> D. Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare ...*, f. 259-260.

<sup>33</sup> *AQSH*, F. 161, V. 1939, D. 651, fl. 18. Shkresë e Këshilltarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Mario Morandi drejtuar Mëkëmbësit Jacomoni, Tiranë, 7 nëntor 1939.

Përballë presionit të Vatikanit, Italia u tërhoq, me gjithë dëshirën që kishte për mbylljen e shkollave françeskane duke u mjaftuar vetëm me vendosjen e kufizimeve në numrin e nxënësve, si dhe ata që në vitin e ri shkollor ishin regjistruar tashmë në shkollat shtetërore, të mos lejoheshin të çregjistroheshin dhe ta mbyllnin vitin shkollor aty. Kjo masë e Ministrisë pakësoi regjistrimet në shkollat fillore dhe në liceun “Illyricum”. Një pjesë e nxënësve kishin filluar mësimet në kolegjin “Saverian”. Atyre iu bë me dije që nëse dëshironin mund të ktheheshin pranë institucionit të tyre arsimor.<sup>34</sup> Gjithashtu, në fund të nëntorit 1939, pati edhe kërkesa personale, të drejtuara Mëkëmbësit Jacomoni, nga nxënës maturantë, të cilët të imponuar ishin regjistruar në shkollat shtetërore. Tani që liceu “Illyricum” u rihap dëshironin të riktheheshin pasi sipas tyre programi didaktik i ndryshëm ua vështirësonte ndjekjen normale të mësimave.<sup>35</sup>

Pushtuesit u përpoqën të impononin ndryshime e “reforma” në fushën arsimore, që prekën dhe institucionet shkollore fetare. Me politikën që ndoqën u përpoqën të favorizonin jezuitët, në radhët e të cilëve kishte priftërinj, kryesisht, italianë, me qëllim nxitjen dhe propagandimin e ideve fashiste. Gjithashtu u munduan t’i vinin kundër njëri-tjetrit dy institucionet arsimore më të hershme e më të rëndësishme në Shkodër me qëllim krijimin e një situatë të turbullt, që do të sillte më shumë përfitime për ta. U shtrua përsëri çështja e reduktimit të gjimnazeve klasike dhe në këtë drejtim prekeshin edhe dy gjimnazet katolike, në Shkodër: ai i jezuitëve, kolegji “Saverian” dhe ai i françeskanëve, liceu “Illyricum”. Rezistenca që i bënë këtyre përpjekjeve, të dy urdhrat fetarë do të jetë e ndryshme.

Në letrën që Provinciali i jezuitëve, padre Paolo Dezza (Paolo Deza) i shkruante Mëkëmbësit Francesco Jacomoni në korrik 1939, vlerësonte punën mbi gjashtëdhjetëvjeçare, të kolegjit “Saverian” në Shkodër, në fushën e arsimit si ndër më të vjetrat shkolla të mesme në Shqipëri, ku mësuan dhe u edukuan figura të njohura shqiptare. Ai ngrinte lart veprimtarinë e jezuitëve në aspektin kulturor, duke përmendur botimin e qindra teksteve shkollore, si dhe të dy revistave kulturore-fetare, të cilat

<sup>34</sup> *Po aty*, F. 132, V. 1939, D. 11, fl. 28. Telegram i drejtorit të liceut “Illyricum” at Donat Kurti drejtuar drejtorisë së kolegjit “Saverian”, Shkodër, 6 nëntor 1939.

<sup>35</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1939, D. 651, fl. 19-20. Letër drejtuar Jacomoni-t nga Lefter Dilo, Stavro Cylaku dhe Ejub Hamzaraj për t’u rikthyer në liceu “Illyricum”, Tiranë, 27 nëntor 1939.

kishin dhënë një kontribut të rëndësishëm në lëmin e kulturës shqiptare. Sipas tij, ky institut i përbërë nga një numër i caktuar drejtuesish e mësuesish italianë “të përkushtuar ndaj Shqipërisë, do të ishte në gjendje të krijonte një ndjenjë mirëkuptimi të ndërsjellë ndaj Italisë Fashiste, e cila kujdesej për mirëqenien dhe barazinë e popujve të saj më shumë se çdo shtet tjetër i Europës”.<sup>36</sup> Nënkuptimi i fjalëve të tij ishte i qartë. Misionin për të afruar shqiptarët me kulturën e idetë fashiste nuk mund ta kryente më mirë se një shkollë e drejtuar nga italianët.

Provinciali i jezuitëve nuk i bëri shumë rezistencë mendimit që ishte shfaqur nga ana e Mëkëmbësisë për një transferim të mundshëm të gjimnazit të tyre nga Shkodra në drejtim të Tiranës. Këtë qytet, madje, e vlerësonte si me më shumë traditë e më të favorshëm, ku mund të punohej më qetë dhe në një ambient intelektual, por nëse për arsye të ndryshme kjo nuk do të ishte e mundur “është dëshira jonë t’i shërbejmë një çështjeje të drejtë duke braktisur pozicionin e vjetër për një të ri -duke shtuar - edhe pse është pak si të lundrosh drejt të panjohurës”. Gjithashtu, ai shprehej i gatshëm se “nëse është interesi i përbashkët”, mund të sakrifikohej liceu klasik, duke e kthyer atë në një lice shkencor, por vinte në dukje edhe faktin se praktikisht kjo do të sillte vështirësi të shumta për drejtuesit e shkollës.<sup>37</sup>

Rivaliteti mes dy shkollave katolike ishte gjithmonë prezent dhe i dukshëm duke qenë se ato ndodheshin në të njëjtin qytet. Për Provincialin e jezuitëve ishte më e thjeshtë dhe mbase një zgjidhje, transferimi i shkollës së tyre në kryeqytet, pavarësisht se nuk linte pa përmendur edhe rreziqet që mbarte ky veprim. Shkolla e drejtuar, që në fillimet e veta nga jezuitë italianë dhe mësues laikë, ishte dalluar për metodat didaktike që përdorte, duke zgjuar tek të rinjtë dëshirën për të mësuar, për t’u aftësuar në thellimin e njohurive, si dhe për të nxitur pasionin për studimet, përmes stimujve të ndryshëm.<sup>38</sup> Tashmë ajo kishte krijuar një traditë në mësimdhënie dhe ndryshimi i drejtimit nga lice klasik në atë shkencor do të sillte vështirësi jo vetëm organizativo-administrative, por edhe kundërshtime nga ana e personelit dhe drejtuesve, megjithëse për hir të ndjekjes së një politike mbështetëse ndaj synimeve të Italisë, mund të

<sup>36</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1939, D. 1036, fl. 1. Letër e Provincialit të jezuitëve drejtuar Mëkëmbësit Jacomoni, Shkodër, 19 korrik 1939.

<sup>37</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>38</sup> *Il Collegio Saveriano di Scutari d’Albania nei primi cinquant’anni 1877-78 – 1927-1928*, Torino: Officina Grafica Gaspare Astesano, 1928, f.12.

bëhej një kompromis.

Në lidhje me veprimtarinë e jezuitëve në zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqipe, studiuesi Ernest Koliqi është shprehur me mirënjohje, por sipas tij, përsa i përket zgjimit të ndjenjave kombëtare, kur fillimisht nisën veprimtarinë e tyre në Shqipëri, qëndruan asnjëherë, pasi ata ishin të huaj, ndryshe nga përpjekjet e françeskanëve, kleri i të cilëve duke qenë shqiptar punoi më shumë në këtë drejtim.<sup>39</sup> Pa e zbehur aspak rolin dhe kontributin e jezuitëve në fushën arsimore, kulturore e fetare, ata duke pasur në përbërje të stafit drejtues italianë, nuk do ta kishin të vështirë të plotësonin kërkesat e Mëkëmbësit për transferim e ndryshim drejtimi të kolegjit të tyre, ndonëse kjo sillte efekte negative në traditën arsimore, që me mund e kishin vendosur gjatë gjithë këtyre viteve.

Nga ana tjetër, italianët donin të jepnin një mesazh të fortë dhe të qartë për françeskanët. Goditjet ndaj shkollave të tyre ishin një presion për t'i detyruar që t'i mbyllnin vetë ato. Duke larguar drejt kryeqytetit kolegjin "Saverian" dhe duke i krijuar vështirësi liceut "Illyricum" mendonin se kishin gjetur mënyrën të shuanin një vatër të rezistencës ndaj tyre.

Por, do të ishin vetë iniciuesit e kësaj përpjekjeje, që duke bërë një analizë më të thelluar të situatës dhe llogaritur mirë pasojat që mund të vinin nga këto masa të nxituara, do të bënin mbrapsht në kërkesat e tyre. Këshilltari i Përhershëm i Ministrisë së Arsimit, Morandi në gusht 1939, i dërgoi një relacion rezervat Mëkëmbësit Jacomoni. Ai ishte kundër mbylljes së gjimnazit-lice, dega klasike, të Urdhrit Jezuit, i njohur si kolegji "Saverian" dhe kthimit të tij në shkollë teknike-tregtare. Ndonëse kjo masë mund të merrej në kuadër të reduktimit të gjimnazeve klasike, sipas tij rrezikonte "të shkatërronte të vetmin institucion shkollor në Shkodër që kishte dhënë prova konkrete të italianitetit", kishte përshtatur metodat didaktike mësimore me principet italiane dhe kishin bërë studime të thelluara të zakoneve, traditave e letërsisë shqipe, duke fituar respektin e vlerësimin e popullit, me gjithë konkurrencën e fortë të gjimnazit të françeskanëve dhe të gjimnazit të shtetit.<sup>40</sup>

Iniciativa për ndryshime në aspektin arsimor nuk mundi të realizohej,

<sup>39</sup> Ernest Koliqi, *Syzime letrare. Shkrime kritike: Vepra 5*, Prishtinë: Faik Konica, 2003, f. 21.

<sup>40</sup> *AQSH*, F. 161, V. 1939, D. 651, fl. 14. Relacion rezervat i Këshilltarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Mario Morandi drejtuar Mëkëmbësit Jacomoni, Tiranë, 28 gusht 1939.

pasi vetë Këshilltari i Përhershëm Morandi, duke vënë interesin politik italian në radhë të parë dhe duke gjykuar me gjakftohtësi, theksonte se mbyllja e kolegjit “Saverian” në Shkodër edhe sikur të rihapej në Tiranë, do të sillte avantazhe të mëdha për gjimnazin e françeskanëve e indirekt edhe atë të motrave Stigmatine, të cilët në procesin e edukimit njiheshin për qëndrime antiitaliane. Në fund ai e mbyllte relacionin me sugjerimin se, Mëkëmbësia jo vetëm nuk duhej të lejonte mbylljen e tij, por madje të shtonte ndihmat financiare, duke i nxitur të zbatonin më shumë një frymë italiane e fashiste në institutin e tyre. Ndërsa françeskanëve dhe motrave Stigmatine u duheshin mohuar, ose reduktuar ndihmat financiare deri në atë pikë sa të detyroheshin të hiqnin dorë nga aktiviteti shkollor. Sipas tij, kjo masë ishte e nevojshme në situatën komplekse që po kalonte vendi, si nga ana politike, ashtu dhe arsimore. Si justifikim ato mund të argumentonin se, kjo po bëhej në kuadër të rregullimit të shkollave të mesme në Shqipëri.<sup>41</sup> Ishte mëse i qartë karakteri politik i ristrukturimit të shkollave të mesme, i cili po realizohej për të goditur vatrat antiitaliane. Për momentin moszbatimi i tij, ishte një fitore për shkollat françeskane.

Kolegji “Saverian” e vazhdoi veprimtarinë e tij të mëparshme. Në një relacion, të cilin për fat të keq nuk e disponojmë të plotë, mësojmë se në vitin shkollor 1940-1941, në shkollën fillore pranë tij ishin regjistruar gjithsej 112 nxënës shqiptarë. Nga këta, kishte nxënës që mbeteshin për t’u riprovuar në vjeshtë me një ose dy lëndë, ndërsa 20 prej tyre nuk e kalonin klasën. Në kolegjin e drejtuar nga jezuitët në programin mësimor do të kishte edhe lëndë ideologjike, në shërbim të politikës italiane. Në një pikë të relacionit, thuhej se, në klasën e tretë e të katërt të kursit të ulët dhe të lartë të liceut nuk mësoheshin lëndët Kultura Fashiste e Doktrina Fashiste. Ndërsa, për nxënësit italianë që ndiqnin mësimet në klasat e ndryshme të liceut nuk ishte i detyrueshëm mësimi i gjuhës shqipe<sup>42</sup>, ndërkohë që gjuha italiane për nxënësit shqiptarë ishte pjesë e programit mësimor.

Për të krijuar një tablo më të qartë të shkollave mashkullore dhe femërore të drejtuara prej françeskanëve, na vjen në ndihmë një promemorie e tyre drejtuar Mëkëmbësisë në fund të vitit 1939. Një gjimnaz me tetë klasë dhe një shkollë fillore me pesë klasë ishin shkolla

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> *Po aty*, F. 132, V. 1941, D. 11, fl.15. Relacion i kolegjit “Saverian” (i paplotë), 1941.

mashkullore.<sup>43</sup> Disa nga lëndët që zhvilloheshin në “kursin e naltë” të liceut, dega klasike, sipas një dëftese të lëshuar në Shkodër në tetor 1939, ishin: besim, gjuhë shqipe, gjuhë latine, gjuhë greke, italisht, histori, gjeografi, matematikë, fizikë, kimi, histori natyre [dituri natyre], filozofi etj.<sup>44</sup>

Shkollat femërore drejtoheshin nga motrat Stigmatine dhe përfshinin kopshte për fëmijë, shkolla fillore, shkolla pune dhe një gjimnaz, të shpërndara këto në disa qytete e zona të Shqipërisë, kryesisht në veri, Shkodër, Shirokë e Dajç, kryeqytet dhe në Korçë. Kontributi i tyre ishte i çmuar jo vetëm për faktin se u mësonin fëmijëve shkrim e lexim, por edhe i aftësonin ata në shkollat e punës. Motrat françeskane ishin me kombësi shqiptare dhe mësimin e gjuhës italiane e zhvillonin vetëm në Korçë, çka flet për një karakter patriotik e kombëtar të aktivitetit të tyre fetar.<sup>45</sup>

Pjesë e promemories ishin edhe kërkesat për ndihma financiare në shkollat fillore e të mesme, si mashkullore ashtu edhe femërore, për zhvillimin e veprimtarive të tyre kulturore.<sup>46</sup> Në realitet po ndodhte një paradoks i çuditshëm, pasi gjatë viteve të qeverisjes së A. Zogut ato kishin përfitur ndihma nga qeveria italiane, kurse tani që italianët drejtonin vendin po tregoheshin të kursyer. Ata po vendosnin kushte për dhënien e tyre, duke kërkuar në këmbim mbështetje politike ndaj regjimit të ri.

Ministria e Arsimit përmes Këshilltarit të Përhershëm, Mario Morandi, në shkurt 1940 i dërgonte një relacion Sekretarit të Përgjithshëm të Mëkëmbësisë Meloni, lidhur me disa nga pikat që parashtruan françeskanët në promemorien e tyre. Ai shprehej, se këto shkolla duhej të vlerësonin mundësinë që po u krijoheshin dhe të përfitonin nga politika e reduktimit të shkollave shtetërore, pasi tani do të regjistroheshin më shumë nxënës në institucionet e tyre. Por, ata duhej të jepnin garanci për këtë lëshim që po u bëhej, në mënyrë që nxënësit e ngelur në provime nëpër licetë shtetërore, të mos dyndeshin në këto

<sup>43</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1939, D. 651, fl. 5. Promemorie e Provincës Françeskane drejtuar Mëkëmbësisë, Shkodër, 17 dhjetor 1939.

<sup>44</sup> *Po aty*, F. 132/A, V. 1939, D. 63, fl. 5. Dëftesë e liceut “Illyricum”, Shkodër, 11 tetor 1939.

<sup>45</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1939, D. 651, fl. 7. Promemorie e Provincës Françeskane drejtuar Mëkëmbësisë, Shkodër, 17 dhjetor 1939.

<sup>46</sup> *Po aty*, fl. 5-7.

shkolla ku nuk paguanin as taksa.<sup>47</sup>

Të krijohet përshtypja sikur ajo çfarë i shqetësonte autoritetet e Ministrisë së Arsimit, ishte cilësia e nivelit të nxënësve nëpër shkollat private fetare françeskane, ndërkohë që atyre iu vendosën kufizime në numrin e nxënësve, mësuesve dhe financimeve pa të cilat nuk mund të funksiononin normalisht. Nga pesë mësues të kërkuar për shkollat e tyre fillore, të cilët caktoheshin e paguheshin nga Ministria, u miratuan vetëm dy të tillë, me justifikimin se, “nuk kishte numër të mjaftueshëm as për shkollat fillore shtetërore”. Ndërsa për profesorë në lice “do të shikohej mundësia e dërgimit të tyre vitin tjetër shkollor dhe për momentin do t’u vihej në dispozicion vetëm një për lëndën e historisë”.<sup>48</sup> Për mësimin e gjuhës e letërsisë italiane, ishte caktuar si mësues që në nëntor 1939, padre Agostin Ashiku, i cili kishte përfunduar studimet për letërsi e filozofi në Universitetin e Firences dhe do të paguhej nga shteti me të njëjtën rrogë që kishte patur më parë.<sup>49</sup>

Të ekzagjeruara u quajtën dhe shumat e parave që kërkonin françeskanët për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre kulturore dhe arsimore, madje ato u konsideruan “në disproporcion me cilësinë e shkollave të tyre”. Si konkluzion, në relacion thuhej se, kërkesat e parashtruara në Promemorie mund të kuptoheshin në kohën kur shteti kishte interes që këto shkolla të funksiononin pasi nuk kishte të tjera, por në situatën në të cilën ndodhej tashmë Shqipëria “shkollat private nuk ishin veçse një formë konkurente e shkollave të shtetit dhe të vështira për t’u kontrolluar”.<sup>50</sup> Me politikën që po ndiqej ndaj shkollave françeskane, siç duket edhe nga raporti, italianëve nuk u kishte pëlqyer sjellja e tyre në muajt e parë të instalimit të pushtetit, prandaj vendosën t’i godisnin në pikën më të ndjeshme, shkollat, aty ku edhe nacionalizmi shfaqej më hapur.

Nuk vonoi shumë dhe pikërisht shkollat e motrave në Tiranë dhe Shkodër, në qershor të vitit 1940, iu nënshtruan një inspektimi nga ana e Ministrisë së Arsimit, përmes inspektore italiane Silvia Doglia (Silvia Dolia). Rezultatet e tij iu dërguan Këshilltarit të Përhershëm, Morandi. U

<sup>47</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1940, D. 796, fl. 3. Promemorie e Këshilltarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Mario Morandi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Mëkëmbësisë Meloni, Tiranë, 13 shkurt 1940.

<sup>48</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 1-2.

<sup>50</sup> *Po aty*, fl. 5.

konstatua se në shkollën e kryeqytetit “klasat dhe shpirtërat ishin të hapura ndaj flladit të jetës që vjen nga vendi ynë”, duke nënkuptuar një mishërim e pasqyrim të jetës fashiste italiane. Ky gjykim jepej pasi realiteti ishte i dukshëm, si në simbolet e vendosura nëpër klasa, ashtu edhe në këngët e fëmijëve e në mënyrën sesi zhvillohej mësimi.<sup>51</sup>

Për shkollën e motrave Stigmatine në Shkodër, në relacion thuhej se “nuk ndihej asnjë grimë dashurie për Italinë dhe ideologjinë fashiste”, në muret e klasave mungonin portretet e Mbretit Vittorio Emanuele III (Viktor Emanueli III) dhe të Benito Mussolini-t (Duce) (Benito Musolini-Duçe) dhe se ato gjendeshin vetëm në zyrën e drejtorisë dhe në kabinetin e fizikës. Justifikimi i dhënë nga ana e drejtoreshës se, nuk kishin gjetur dot portrete në qytet apo se kjo kërkesë mund t’i ishte bërë asaj paraardhëse, e cila nuk kishte shumë kohë që ishte larguar, nuk u dukej i besueshëm. Gjithashtu mungonin krijime letrare rreth tyre, në shkollën e mesme kishin hasur vetëm një hartim mbi Duce-n dhe gjatë orëve të mësimit nuk përmendej fare Italia si dhe nuk studioheshin poezitë “patriotike”. Sipas kontrollit, e diskutueshme ishte dhe mënyra se si mësohej gjuha italiane, pasi ishin përshtatur për shkollën e mesme, tekste që përdorshin në shkollat fillore. Për këtë, motrat jepnin si shpjegim se tekstet për shkollat e mesme nuk kishin tema interesante dhe konceptet ishin të vështira. Si konkluzion arrihej në përfundimin se, shkolla e motrave Stigmatine “përdorte metoda të vjetëruara në mësimdhënie, ajo ishte e mërzitshme, apolitike dhe nuk kishte hapur klasat dhe shpirtërat për zërin e Romës”.<sup>52</sup>

Sa më lart, shihet qartë se, institucionet arsimore françeskane, si mashkullore edhe femërore, u kaluan në sitën e kontrollit për të parë qëndrimin e tyre ndaj regjimit. Siç duket edhe nga konkluzioni i inspektimit, shkolla femërore në Tiranë duke qenë në kryeqytet dhe më e kontrolluar, i ishte përshtatur kërkesave për vendosjen e portreteve të drejtuesve fashistë për të “kënaqur” autoritetet. A ishte kjo thjesht aparence, për të mos i hapur shumë telashe shkollës në një kohë që vuanin nga mungesa financiare, apo një zbatim i përpiktë i udhëzimeve? Vështirë të jepet një përgjigje e saktë. Është fakt se motrat Stigmatine vareshin nga françeskanët dhe ndiqnin të njëjtën linjë me ta. Krejt

<sup>51</sup> *AQSH*, F. 161, V. 1940, D. 809, fl.5. Relacion i inspektores së Ministrisë së Arsimit Sivia Doglia drejtuar Këshilltarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Mario Morandi, Tiranë, 10 qershor 1940.

<sup>52</sup> *Po aty*.



ndryshe paraqitej gjendja në Shkodër. Në këtë qytet, më larg nga qendra dhe katolikë më të shumtë në numër se në Tiranë, drejtueset e shkollës ndiheshin më të sigurta dhe më të lira në vendimmarrje. Një mënyrë e shprehjes së rezistencës së tyre ishte mos përdorimi i teksteve me poezi fashiste, apo ekspozimi nëpër mure i portreteve të pushtuesve.

Vështirësitë ekonomike dhe mungesa e fondeve të mjaftueshme sollën probleme në shpërndarjen e teksteve, që përdorreshin në liceun “Illyricum”. Drejtori i tij, at Donat Kurti, në letrën drejtuar Mëkëmbësisë në tetor 1940, vinte në dukje pamundësinë e tyre për t’u shpërndarë nxënësve tekstet, sidomos atyre që ishin në italisht. Në fjalët e tij ndihej keqardhje për mënyrën sesi kishte ndryshuar qëndrimi i Italisë ndaj tyre. Jo shumë kohë më parë ajo kishte treguar “një interesim të veçantë për shkollat” duke u siguruar tekste e materiale didaktike, të cilat çdo vit ua kishin shpërndarë nxënësve falas. Por, tashmë kjo nuk mund të realizohej më, prandaj ata kërkonin ndihmën e Mëkëmbësisë.<sup>53</sup>

Françeskanët vazhduan me këmbëngulje të punonin dhe të jepnin kontributin e tyre në drejtim të zhvillimit të kulturës shqiptare. Kështu, teksti i punuar nga frati at Justin Rrota, për studimet e thelluara në fushën e gjuhësisë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, më 20 shkurt 1942, u përdor si tekst bazë i sintaksës së gjuhës shqipe, për klasat e II+III+IV të kurseve të ulëta të shkollës së mesme.<sup>54</sup>

### **Përpjekjet për fitimin e statusit ligjor të shkollave private fetare katolike**

Një çështje e mbetur pezull dhe pa zgjidhje përfundimtare ishte edhe ajo e statusit ligjor të shkollave fetare katolike. Qëndrimi i Italisë do të ndryshonte në kushtet e reja politike të krijuara. Në periudhën maj-qershor 1940, në përfundim të vitit shkollor, Këshilltari i Përhershëm i Ministrisë së Arsimit, Mario Morandi i dërgonte një letër Mëkëmbësit Jacomoni, në lidhje me statusin ligjor të kolegjit “Saverian”, i cili prej disa vitesh njihej *de facto* si një shkollë e barabartë me shkollat italiane jashtë shtetit. Ky status i ishte njohur gjatë periudhës së Mbretit Zog, nisur nga interesat italiane për të patur ndikim në Shqipëri përmes

<sup>53</sup> *Po aty*, F. 161, V. 1940, D. 809, fl.9. Shkresë e drejtorit të liceut “Illyricum” at Donat Kurti drejtuar Mëkëmbësisë, Shkodër, 7 tetor 1940.

<sup>54</sup> Mërgim Korça, “Problemi kolaboracionizëm”, në *E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike (4)*, Prizren: Lumbardhi, 2006, f. 152.

arsimimit. Si rrjedhojë, diplomat e lëshuara nga kolegji njiheshin edhe në Itali. Por, për këshilltarin Morandi meqë këto arsye nuk ekzistonin më dhe tashmë në Tiranë ishte hapur liceu-gjimnaz, ishte e pajustificueshme ligjërisht përdorimi i termit *de facto*. Kjo shkollë nuk mund të gëzonte më, të njëjtat të drejta si edhe shkollat italiane, por do të ishte një shkollë private si gjithë të tjerat. Këtë informacion Jacomoni ia përcolli edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke theksuar se etërit jezuitë “nuk kishin kundërshtim e kishin rënë dakord edhe me Ministrinë Shqiptare të Arsimit”.<sup>55</sup> Sa e vërtetë ishte kjo vështirë të besohet. Ndryshimi i statusit që kishin patur nuk ishte diçka e thjeshtë. Gjatë periudhës së monarkisë (1928-1939) italianët i financuan dhe i morën “nën mbrojtje katolikët dhe shkollat e tyre”, duke ua konvertuar edhe diplomat. Por, tashmë këto privilegje nuk po ua njihnin më, me justifikimin se nuk kishin mbështetje ligjore.

Ministria e Arsimit përmes ministrit Koliqi i dërgoi Këshillit të Ministrave, në tetor 1940, një relacion në lidhje me një projektdekret që duhej të miratohej mbi funksionimin e instituteve arsimore private. Që në fillim të tij theksohej vlera dhe rëndësia që kishin patur ato në të kaluarën, por tashmë duhej t’i nënshtroheshin rregullave dhe disiplinimit. Synimi ishte t’i jepeshin Ministrisë kompetenca të gjera në: të drejtën për të hapur ose jo shkolla private; për t’i kontrolluar e inspektuar ato; për të mbyllur institutet private, të cilat nuk e ushtronin veprimtarinë sipas rregullave të vendosura nga Ministria, si dhe të drejtën për të caktuar “një numër të mbyllur” [të kufizuar] për nxënësit, që mund të regjistroheshin në këto shkolla.<sup>56</sup>

Sipas këtij projektdekreti, shkollat private shikoheshin si plotësuese të atyre shtetërore. Në nenin 1 ishte parashikuar që të mos lejohej hapja e shkollave private në ato qytete, ku prej kohësh ekzistonte një shkollë shtetërore me qëllim “mos me shkaktoje një konkurrencë të damshme” mes tyre. Masat ndëshkuese që propozoheshin për këto subjekte shprehnin “vullnetin nga ana e shtetit për me i dhanë këtij sektori delikat

<sup>55</sup> AQSH, F. 161, V. 1940, D. 797, fl.1-5. Korrespondencë e Ministrisë së Arsimit me Mëkëmbësinë në lidhje me kolegjin “Saverian”, Tiranë, 30 maj 1940 dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme me Mëkëmbësinë për kolegjin “Saverian”, Romë, 6 qershor 1940.

<sup>56</sup> Po aty, F. 149, V. 1940, D. IV/22, fl.3. Relacion mbi ligjin për institutet private, Tiranë, 16 tetor 1940.

nji disiplinë të fortë e të sigurtë”.<sup>57</sup>

Autoritetet italiane dhe ato të administratës shqiptare nën pushtim, po përpiqeshin të “zgjidhnin” përfundimisht, çështjen e shkollave private, duke u munduar t’i vendosnin ato nën kontrollin e tyre të plotë. Qëllimi ishte t’u hiqeshin edhe ato pak të drejta që mund të ushtronin dhe ashtu sikurse shkollat shtetërore, të ishin nën varësinë e vëzhgimit e vazhdueshëm të autoriteteve. Përmes teksteve e programeve mësimore, të mund të impononin ideologjinë fashiste.

Mëkëmbësi Jacomoni, më 16 janar 1941, miratoi dekretin “Rregulla për funksionimin e shkollave private” duke i dhënë vlerë ligjore sugjerimeve të bëra nga ana e Ministrisë së Arsimit.<sup>58</sup> Të drejtën për të lejuar hapjen e një shkolle private, fillore apo të mesme, e kishte Ministria e Arsimit. Ato mund të hapeshin vetëm në ato qendra ku nuk ndodhej një shkollë tjetër shtetërore e të njëjtit nivel dhe ishin të detyruara të zbatonin të njëjtin program dhe të njëjtat lëndë si në ato shtetërore. Gjithashtu përcaktohej edhe dokumentacioni i plotë, që duhej të paraqitej pranë Ministrisë së Arsimit, kur kërkohej hapja e shkollës. Për sa i përket “dëshmive” [dëftesë] të lëshuara prej tyre, ato nuk do të kishin vlerë ligjore dhe çdo vit nxënësit mund të jepnin provimet e pranimit, lirimit ose të pjekurisë pranë shkollave përgjegjëse të shtetit.<sup>59</sup>

Mbi bazën e kërkesës që bënte Enti, i cili drejtonte shkollën private, çdo vit Këshilli i Ministrave duke marrë parasysh edhe propozimet e Ministrisë së Arsimit, mund t’u lejonte “selinë ligjore” disa shkollave të caktuara, vetëm për nxënësit e brendshëm. Në këtë mënyrë, u njihej e drejta, ashtu si edhe në shkollat shtetërore, për të zhvilluar provimet e lirimit apo të pjekurisë. Gjithashtu lejimi i kësaj selie, nënkuptonte njohje ligjore e dëftesave të lëshuara prej tyre. Gjatë provimeve duhej të merrnin pjesë edhe një ose disa të dërguar nga Ministria. Kjo e fundit kishte të drejtë të dërgonte në çdo kohë nëpunësit e vet për kontroll, apo inspektim, si dhe të pezullonte veprimtarinë e shkollës private, kur viheshin re parregullsi në mbarëvajtjen e saj, në kundërshtim me udhëzimet që përcaktonte Dekreti, ose mund të gjobiste në shumën nga 100-1000 fr.shq., ose të hiqte autorizimin e dhënë. Me këtë Dekret Mëkëmbësor shfuqizohej dekretligji i 9 majit 1936 mbi funksionimin e

<sup>57</sup> *Po aty*, fl.4.

<sup>58</sup> *Fletore zyrtare*, nr.12, Tiranë, 28 janar 1941, f. 2.

<sup>59</sup> *Po aty*, f. 3.

shkollave private, i miratuar në periudhën e A. Zogut.<sup>60</sup>

Në këtë mënyrë iu dha formë ligjore dhe juridike mënyrës sesi do të funksiononin shkollat private, duke i dhënë fund një periudhe “të turbullt”, ku italianët herë kishin lejuar e herë i kishin ndaluar ato, sipas interesave të tyre. Përmes dekretit të miratuar ata i vendosën shkollat private nën kontroll dhe i quajtën thjesht ndihmëse të sistemit arsimor shtetëror, duke mos u njohur ligjërisht diplomat. Kleri katolik njihej për kundërshtimet e tij të forta dhe një vit më parë, përplasjet e françeskanëve me italianët, për shkollat e tyre kishin vënë në lëvizje Selinë e Shenjtë. Mbase për të shmangur një reagim tjetër nga ana e saj, u treguan të kujdesshëm duke lënë një klauzolë, për të mos i përjashtuar plotësisht ato nga e drejta për të lëshuar dëftesa, por duke e lënë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit për të vendosur se cili institucion do të lejohej. Ajo do të zbatonte ligjin apo do të tregohej selektive duke vendosur për shkollën që e shikonte “të arsyeshme”.

Pas gati gjashtë muajsh, me propozim të Ministrisë së Arsimit, e cila provoi se kolegji “Saverian” kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 668, datë 13 qershor 1941, vendosi t’i lejohej kësaj shkolle selia ligjore e provimeve. Bashkë me të u lejua që të hapeshin një kurs fillor i plotë prej pesë klasash, një kurs normal që fillonte me klasën e parë të kursit të ulët në vitin shkollor 1940-1941 dhe me të drejtë të shtimit të klasave në vitet shkollore që do të pasonin deri në plotësimin e kursit të ulët e të lartë, si dhe një kurs liceu i plotë, i ulët dhe i lartë.<sup>61</sup>

Lejimi i selisë ligjore të provimeve i njihte *de jure* kolegjit “Saverian” të drejtën për të lëshuar dëftesa, si dhe për të shtuar kurset e saj edhe pse në qytetin e Shkodrës ekzistonte një lice-gjimnaz shtetëror. Ky vendim binte në kundërshtim me propozimin e këshilltarit Morandi të një viti më parë, për të mos iu njohur kjo e drejtë jezuitëve, të cilët sipas tij nuk e kishin menaxhuar si duhet këtë proces. Në këtë mënyrë italianët “zgjidhën” dy çështje. Së pari, treguan se kush “plotësonte kushtet sipas ligjit” do të përfitonte, duke ia akorduar të drejtën vetëm kolegjit “Saverian” i drejtuar nga jezuitët. Së dyti, iu dha një mesazh i qartë françeskanëve se, statusi i shkollës së tyre ishte në dorë të italianëve dhe

<sup>60</sup> *Po aty*, f. 4.

<sup>61</sup> *AQSH*, F. 132, V. 1941, D. 11, fl.3. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 668, datë 13 qershor 1941, për lejimin e ngritjes së selisë së provimeve në kolegjin “Saverian”.

megjithëse kishin kërkuar me ngulm barazimin e shkollave, për momentin, nuk iu dha kjo e drejtë.

Më në fund, pas insistimeve, kërkesave të përsëritura dhe këmbëngulëse nga ana e françeskanëve e jezuitëve, u hap drita jeshile për të miratuar një dekret që do të lejonte barazimin e shkollave private me ato shtetërore. Me dekret të Mëkëmbësit, datë 12 dhjetor 1942 u miratua dekretligji “Për barazimin e shkollave private”, i cili hyri në fuqi më 16 janar 1943, pasi u botua në “Fletoren Zyrtare”.<sup>62</sup> Sipas tij, shkollat e mesme private të autorizuar, që plotësonin kushtet e caktuara nga ky dekret mund të fitonin barazimin ligjor të studimeve me ato të shkollave shtetërore dhe do të quheshin “shkolla të barazueme”.

Këtë të drejtë e fitonin ato shkolla private, që drejtoheshin prej Entesh si urdhri jezuit e ai françeskan, që kishin funksionuar të paktën dhjetë vjet para hyrjes në fuqi të këtij dekreti. Me Dekret Mëkëmbësor pas propozimit të Ministrit Sekretar të Shtetit për Arsimin e pasi të merrej edhe miratimi i Këshillit të Ministrave i njihej statusi “shkollë e barazueme”.<sup>63</sup> Në të përcaktohej si do të bëheshin pranimet e nxënësve dhe si do të zhvilloheshin provimet. Ky status mund të revokohej në çdo kohë të vitit shkollor, nëse vërtetoheshin parregullsi në funksionimin e shkollës, kur nuk respektoheshin dispozitat ligjore, ose urdhrat e Ministrisë. Të gjitha tekstet shkollore duhej të ishin në gjuhën shqipe, përveç atyre në gjuhë të huaj. Sa i përket mësimdhënësve për t’u punësuar si definitiv, apo zëvendësues, kandidatët duhej të plotësonin të gjitha kushtet që kërkoheshin edhe për arsimtarët e shkollave shtetërore korresponduese. Emërimi e shkarkimi i drejtorit bëhej prej Entit që financonte shkollën, por duhej të merrej edhe pëlqimi prej Ministrisë së Arsimit.<sup>64</sup>

Ministria e Arsimit në raportin justifikues paraqiste si arsye për një vendim të tillë edhe kontributin e hershëm të etërve françeskanë e jezuitë të Shkodrës, në fushën e kulturës e të dijes, si të parët që kishin hapur shkollat e tyre, të cilat ishin më të vjetrat në Shqipëri. Gjithashtu u vlerësua fakti se, në veprimtarinë e tyre ato kishin zbatuar urdhrat e Ministrisë, kishin funksionuar sipas programeve të miratuara për shkollat

<sup>62</sup> *Po aty*, F. 149, V. 1942, D. IV-56, fl.1. Dekret i Mëkëmbësit, datë 12 dhjetor 1942, për fitimin e statusit “Shkollë e barazuar” për shkollat private; shih dhe *Fletore zyrtare*, nr. 5, Tiranë, 16 janar 1943, f. 2.

<sup>63</sup> *Po aty*.

<sup>64</sup> *AQSH*, F. 149, V. 1942, D. IV-56, fl.2.

shtetërore dhe nga inspektimet e herëpashershme, ishin gjetur në rregull nga pikëpamja didaktike, mësimore e disiplinore.<sup>65</sup>

*De jure* licetë e françeskanëve dhe jezuitëve, fituan të drejtën e barazimit me shkollat shtetërore të të njëjtit nivel, pas botimit në “Fletoren Zyrtare” të Dekreteve Mëkëmbësore: për të parët datë 25 maj 1943 dhe për të dytët datë 18 qershor 1943. Liceu i françeskanëve me degët e tij reale dhe klasike u quajt tashmë “Liceu i Barazuem Illyricum”, ndërsa kolegji klasik i jezuitëve u barazua me licetë klasike shtetërore, duke u quajtur “Liceu i Barazuem Saverian”.<sup>66</sup>

Situata politike në Shqipëri do të ndryshonte shpejt, me kapitullimin e Italisë më 8 shtator 1943, duke e zbehur disi fitoren e arritur, pas aq shumë përpjekjesh me pushtuesit italianë.

### **Organizimi dhe veprimtaria e Seminarit Papnor**

Shkodra si qendra kryesore e katolikëve në Shqipëri, ishte një qytet që ofronte mundësi të shumta për arsimimin e tyre. Në të ndodhej edhe Seminari Papnor Shqiptar, i cili kishte rëndësi për përgatitjen e priftërinjve të rinj vendas, që më pas do të shërbenin në zona të ndryshme të Shqipërisë. Në lidhje me krijimin dhe organizimin e brendshëm të tij, gjatë pushtimit italian, vjen në ndihmë një rregullore e miratuar në qershor 1940.<sup>67</sup> Në të përcaktohej se ai ishte një institut që përgatiste klerikë, varej nga Selia e Shenjtë, por ishte nën drejtimin e Kongregacionit të Propagandës Fide, përmes Delegatit Apostolik. Administrimi, disiplina dhe mësimdhënia i ishin besuar etërve jezuitë, të Provincës Veneto-Milaneze, të cilët siguronin numrin e nevojshëm të mësuesve për klasa të ndryshme. Seminari përfshinte kursin komplet, pesë vite gjimnaz, tre vite filozofi e katër teologji dhe drejtohej në bazë të një rregulloreje të aprovuar nga Propaganda Fide. Programi i studimeve hartohej sipas udhëzimeve të lëshuara nga Vatikani dhe ishte i njëjtë me atë të seminareve të ngjashme në Itali, natyrisht duke mbajtur në konsideratë edhe kushtet lokale që kishin të bënin me gjuhën, historinë e

<sup>65</sup> *Po aty*, fl.17.

<sup>66</sup> *Fletore zyrtare*, nr. 72, Tiranë, 28 qershor 1943, f. 2; *po aty*, nr. 79, Tiranë, 20 korrik 1943, f. 4.

<sup>67</sup> *AQSH*, F. 132/A, V. 1940, D. 75, fl.1. Norme per il Seminario Interdiocesano dell'Albania con sede a Scutari (Rregullore e Seminarit Papnor në Shkodër), 1 korrik 1940.

gjeografinë. Rektori zgjidhej nga Drejtuesi i Përgjithshëm i Urdhrit Jezuit dhe aprovohej nga Propaganda Fide, ndërsa caktimi i drejtuesve të tjerë ose mësuesve i takonte Urdhrit duke u bazuar në rregullat e brendshme. Natyrisht drejtuesit e urdhrit jezuit në Shqipëri dhe ata të Provincës Veneto-Milaneze kishin detyrimin të informonin Propagandën Fide rreth mbarëvajtjes së Seminarit me relacione të rregullta, të paktën një herë në vit. Gjithashtu duhej të sqaronin, përmes Delegatit Apostolik, për çdo ndryshim që ishte bërë ose do të bëhej në të ardhmen duke mbajtur në konsideratë se, në poste të rëndësishme drejtuese nuk duhej të bënin ndryshime të shpeshta personeli.<sup>68</sup>

Jezuitët njiheshin për një disiplinë të ashpër. Kështu p.sh. në rast se një nxënës nuk merrte “provimet kyç” në lëndë si filozofia ose teologjia, ai përjashtohej nga procesi mësimor. Atyre nuk u lejohej leximi i periodikëve apo librave “të rrezikshëm” edhe pse Kisha Katolike nuk i ndalonte.<sup>69</sup> Në njërën nga pikat e rregullores ku flitej për nxënësit mësojmë se, në këtë Seminar dërgoheshin ata fëmijë shqiptarë, të cilët do të bëheshin priftërinj. Numri i tyre, për secilën dioqezë, rajon kishtar i administruar nga një ipeshkëv (njësi administrative fetare) do të caktohej sipas nevojave që kishte secila prej tyre, në marrëveshje me rektorin e seminarit dhe më pas miratoheshin nga Delegati Apostolik. Nxënësit që shquheshin për veti të larta morale dhe inteligjencë, i propozoheshin Kongregacionit të Propagandës Fide nga rektori, për të vazhduar studime më të larta akademike. Për ndonjë që nuk kishte sjellje korrekte zbatoheshin edhe masa ekstreme si përjashtim i menjëhershëm. Nxënësit jetonin në konvikte dhe gëzonin të drejtën e pushimeve pranë familjeve, përreth 15-20 ditë gjatë vjeshtës e verës. Pjesën tjetër të tyre e kalonin në seminar duke ndjekur kurse të ndryshme kulturore-fetare.<sup>70</sup>

Nga drejtuesit e Seminarit, rektori kishte një rol të rëndësishëm në organizimin e brendshëm. Herë pas here ai bënte takime personale me seminaristët edhe për të studiuar karakterin dhe anën shpirtërore të priftërinjve të ardhshëm. Në fund të çdo semestri ishte i detyruar t'i relatonte Delegatit Apostolik në lidhje me sjelljen morale, disiplinën e

<sup>68</sup> *Po aty.*

<sup>69</sup> Alighiero Tondi, *La Potenza segreta dei gesuiti*, Rome: La Stella Alpina, 1953, f. 20, 28.

<sup>70</sup> *AQSH*, F. 132/A, V. 1940, D. 75, fl.2. Norme per il Seminario Interdiocesano dell'Albania con sede a Scutari (Rregulla për Seminarin Papnor të Shqipërisë me qendër në Shkodër), 1 korrik 1940.

mbarëvajtjen në mësim të Seminarit. Një tjetër drejtues ishte edhe padre Ministri, i cili jetonte pranë nxënësve me qëllim që të kuptonte sa më shumë rreth tyre për sa i përkiste botës së brendshme shpirtërore, t'u njihte prirjet etj. Informacionin që i jepte rektorit për secilin prej tyre, ndihmonte në caktimin dhe ndarjen e përgjegjësive për të ardhmen.<sup>71</sup>

Për sa i përket mësuesve ata kishin një numër të caktuar orësh në varësi të lëndës dhe në fund të çdo semestri jepnin një relacion me shkrim në lidhje me pjesën e programit që kishin realizuar. Në mbledhjen e fundit të këshillit pedagogjik jepnin sugjerimet e tyre për vitin vijues, rreth programit dhe testeve që do të zhvillonin. Para se të mbyllej viti shkollor, shqyrtoheshin çështje të ndryshme, mes tyre rastet e nxënësve që duheshin përgëzuar për arritjet apo të atyre që mund të përjashtoheshin për rezultate të dobëta.<sup>72</sup>

Nga një relacion i Seminarit Papnor për vitin shkollor 1941-42, mësojmë më shumë rreth organizimit të tij. Disa nga lëndët që zhvilloheshin në drejtimin klasik ishin: besim, filozofi, gjuhë shqipe, latinisht, italisht, greqisht, histori, ndërsa në drejtimin real dhe shkencor lëndët: matematikë, fizikë, kimi e mineralogji.<sup>73</sup>

Nxënës shqiptarë mund të dërgoheshin edhe në Kolegjin Papnor të Propagandës Fide, në Romë. Për vitin shkollor 1941-1942, rezulton se argjipeshkvia e Shkodrës dhe e Durrësit kishin dërguar nga katër nxënës secila; Dioqeza e Sapës një nxënës; dhe Abacia e Mirditës tre nxënës.<sup>74</sup> Rektor i seminarit në vitin 1943 ishte caktuar Gjon Karma, ndërsa mes mësuesve që jepnin mësim ishin: Gjon Fausti (filozofi); Daniel Dajani (filozofi e gjuhë shqipe); Mark Harapi (teologji); Victor Milizia (Viktor Milicia) (gjuhë italiane) etj.<sup>75</sup>

Seminari Papnor pati meritë e kontribut në krijimin e një klase klerikësh katolikë vendas, të cilët morën arsim dhe edukim të niveleve europiane. Ai së bashku me kolegjin “Saverian” e liceun “Illyricum”, në

<sup>71</sup> *Po aty*, fl.3-4.

<sup>72</sup> *Po aty*.

<sup>73</sup> *Po aty*, F. 132, V. 1941, D. 11, fl.43-49. Orario e programmi d'insegnamento del Liceo Pontificio, anno scolastico 1941-1942 (Orari dhe programi mësimor në Seminarin Papnor, viti shkollor 1941-1942).

<sup>74</sup> *Po aty*, F. 132/A, V. 1941, D. 60, fl. 46. Pasqyrë e nxënësve të Kolegjit Papnor të Propagandës Fide, Romë, viti shkollor 1941-1942.

<sup>75</sup> *Catalogus Provinciae Veneto-Mediolanensis, Societatis IESU, anni 1945, PATAVII: Seminari, 1945, f. 29.*



Shkodër, qendër e katolicizmit në Shqipëri, ndihmuan në zhvillimin e arsimit shqiptar, rritën nivelin e shkollimit të të rinjve, duke ecur paralelisht përsa i përket cilësisë së mësimdhënies edhe me shkollat shtetërore shqiptare, në një kohë të vështirë kur vendi ndodhej i pushtuar dhe rrethanat e luftës impononin zgjidhje dhe zgjedhje të vështira.

\*\*\*

Veprimtaria e shkollave katolike në Shqipëri është e hershme. Pas krijimit të shtetit shqiptar, ecuria e tyre në lidhje me të u shoqërua nga ulje e ngritje, që kishin të bënin me procesin e kombëtarizimit të institucioneve arsimore, si dhe presionin që Italia dëshironte të ushtronte përmes tyre. Seminari Papnor e kolegji “Saverian” të drejtura nga etërit jezuitë dhe liceu “Illyricum” nga françeskanët, e vazhduan veprimtarinë e tyre arsimore edhe gjatë pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Deri më tani studimet në lidhje me këtë tematikë, për këtë periudhë, janë të pakta. Prandaj artikulli përbën risi për studimet rreth Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Pas prillit të vitit 1939, me instalimin e autoriteteve të pushtimit, qëndrimi i italianëve ndaj shkollave katolike ndryshoi. Ata nuk luajtën më rolin e mbrojtësit të tyre si në vitet e mbretërimit të Zogut. Fillimisht nën petkun e ndryshimeve dhe “reformave” në fushën arsimore u përpoqën të reduktonin numrin e gjimnazeve klasike, duke ndikuar direkt në të ardhmen e kolegjit “Saverian” dhe liceut “Illyricum”. Sjellja e jezuitëve dhe françeskanëve ndaj kërkesave e imponimeve italiane do të ishte e ndryshme. Të parët u treguan të gatshëm të arrinin në kompromise, ndërsa të dytët mbajtën qëndrime kundërshtuese dhe shprehën rezistencë deri në veprime radikale si mbyllja e shkollës, për vitin shkollor 1939-1940.

Çështja më e diskutueshme gjatë kësaj periudhe ishte ajo e statusit ligjor të shkollave private-fetare katolike, që nxori në pah trajtimet diferencuese të pushtuesve italianë në favor të jezuitëve. Pas insistimeve e kërkesave të përsëritura, sidomos të françeskanëve, më në fund u fitua e drejta e barazimit të shkollave katolike me shkollat shtetërore të të njëjtit nivel. Ky sukses u arrit në një moment, kur pozitat e Italisë në Shqipëri ishin lëkundur fort dhe pas pak muajsh ajo do të kapitullonte.

Gjithashtu një kontribut të veçantë në shtimin e elementit klerikal vendas dha Seminari Papnor, në të cilin çdo vit regjistroheshin të rinj nga

argjipeshkvitë apo dioqezat shqiptare. Ndërsa, në qytetet e Shkodrës, Tiranës e Korçës shkollat femërore të drejtuara nga motrat françeskane Stigmatine ndihmuan jo vetëm në mësimin e shkrim-leximit të fëmijëve, por edhe në aftësimin praktik të tyre në shkollat e punës.

Sjellja ndaj institucioneve arsimore të katolikëve u diktua nga interesat italiane në Shqipëri, duke u përpjekur t'i mbanin ato nën kontroll dhe të shuanin çdo vatër rezistence, por pa mundur t'ia arrinin plotësisht qëllimit.

### *S u m m a r y*

#### CATHOLIC SCHOOLS DURING THE ITALIAN OCCUPATION (APRIL 1939-SEPTEMBER 1943)

The activity of Catholic schools in Albania dates back a long time ago. After the creation of the Albanian state, its progress in relation to it was accompanied by its ups and downs, which had to do with the process of nationalization of education, as well as the pressure that Italy would like to exert through them. The Pontifical Seminary and the "Saverian" college, led by the Jesuit Fathers and the lyceum "Illyricum" by the Franciscans, continued their educational activity even during the occupation of Albania by Italy. So far studies on this topic, for this period, are few. Hence this article brings novelty for the studies about the Second World War in Albania.

After April 1939, with the installation of the occupation authorities, the attitude of the Italians towards Catholic schools changed. They no longer played the role of their protector as in the years of the reign of Zog. Initially under the changes and "reforms" in the field of education they tried to reduce the number of classical gymnasiums, directly affecting the future of the college "Saverian" and lyceum "Illyricum". The attitude of Jesuits and Franciscans to the demands of Italian impositions would be different. The first were shown to be ready to arrive at compromises, while the latter held opposing positions and expressed resistance to radical actions such as closing the school, for the academic year 1939-1940.

The most controversial issue during this period was that of the legal status of Catholic private-religious schools, which highlighted the differentiating treatment of the Italian occupiers in favor of the Jesuits. After repeated insistences and demands, especially from the Franciscans, the right to equate Catholic schools with state schools of the same level was finally won. This

---

success was achieved at a time when Italy's position in Albania had dramatically changed and in a few months it would capitulate.

Another special contribution to the increase of the local clerical element was the Pontifical Seminary, in which every year young people from the Albanian archbishops or dioceses were registered. Whereas, in the cities of Shkodra, Tirana and Korça, the girls' schools run by the Franciscan Stigmatine sisters helped not only in teaching children to read and write, but also in their practical training in work schools.

The attitude towards the educational institutions of the Catholics was dictated by the Italian interests in Albania, trying to keep them under control and to extinguish any resistance, but without being able to fully achieve the goal.

